

Aktivitet me temë "Të jesh bankier i suksesshëm"

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit, kanë organizuar pranë Fakultetit Ekonomik, aktivitetin me temë "Të jesh bankier i suksesshëm", prezantuar nga Z.Erion Qosja, Këshillues Biznesi pranë Credins Bank, Dega Elbasan.

Në prezantimin e tij, Z.Qosja u ndal në sistemin bankar, shërbimet bankare, roli dhe funksioni i bankierit, cilësitë dhe aftësitë që duhet të ketë në punën e tij.

Ky aktivitet mbylli siparin e një sërë aktivitetesh promovuese për studentët që Zyra e Këshillimit të Karrierës, ka zhvilluar përgjatë këtij viti akademik, në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit.

